

L I G J
Nr.8235, datë 28.8.1997

PËR PROCEDURËN E ZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe të nenit 1, të ligjit nr.8234, datë 27.8.1997 "Për një ndryshim në ligjin nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Presidentit të Republikës

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë mund të jetë çdo jurist që plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) të jetë shtetas shqiptar,
- b) të ketë zotësi të plotë juridike për të vepruar,
- c) të ketë vjetërsi në punë si jurist jo më pak se dhjetë vjet,
- ç) të ketë cilësi të larta profesionale dhe etiko-morale,
- e) të jetë zgjedhur sipas procedurës që parashikon ky ligj.

Neni 2

Zgjedhja e juristëve për në Këshillin e Lartë të Drejtësisë nga radhët e gjykatësve e të prokurorëve, bëhet përkatësisht nga mbledhja e gjykatësve dhe e prokurorëve. Ndërsa për zgjedhjen e juristëve nga Kuvendi Popullor, do të zbatohen rregullat mbi bazën e të cilave vepron Kuvendi Popullor.

Për efekt të këtij ligji, me mbledhje do të kuptohet pjesëmarrja në mbledhjet përkatëse e të gjithë gjykatësve dhe prokurorëve të Republikës, ose e përfaqësive të tyre nga çdo gjykatë a prokurori. Përfaqësia zgjidhet nga mbledhja e gjyqtarëve të çdo gjykate dhe nga mbledhjet e prokurorëve të çdo prokurorie.

Neni 3

Kandidaturat për anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë propozohen në mbledhjet përkatëse nga vetë gjyqtarët e prokurorët e pranishëm. Mbledhja është e vlefshme kur në të marrin pjesë shumica e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Një kandidaturë mund të paraqitet nga jo më pak se 10 veta të pranishëm në mbledhje. Një person mund të bëjë pjesë vetëm në një grup propozimi.

Neni 4

Mbledhja zgjedh një komision votimi i përbërë prej pesë vetash me përfaqsim nga nivelet e ndryshme të gjykatave dhe prokurorive.

Votimi për kandidaturat e paraqitura bëhet i fshehtë. Kandidaturat, të cilat mbas numrimit të votave, renditen në tre vendet e para për gjyqtarët dhe dy vendet e para për prokurorët, fitojnë të drejtën për anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Rezultati i votimit shkruhet në një procesverbal i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit.

Neni 5

Ngarkohet Ministri i Drejtësisë, kryetari i Gjykatës së Kasacionit dhe Prokurori i Përgjithshëm, për zbatimin e këtij ligji.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi ditën e shpalljes nga Presidenti i Republikës.

Shpallur me dekretin nr.1883, datë 28.8.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani